



www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2014 – Numri: 151

Tiranë – E Premte, 3 Tetor 2014

## PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 619, datë 24.9.2014	Për emërimin në detyrë të dy anëtarëve të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit e të Përpunimit të Ujërave të Ndotura..... 7915
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 620, datë 24.9.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 411, datë 20.6.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për bashkëfinancimin e projektit të stadiumit “Ruzhdi Bizhuta”, Elbasan, dhe financimin e parkut olimpiq të Tiranës”..... 7915
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 621, datë 24.9.2014	Për disa ndryshime në vendimin nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të këshillave, bordeve ose komisioneve të njësisve të qeverisjes qendrore”, të ndryshuar..... 7915
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 622, datë 24.9.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurave e të dokumentacionit për hyrjen, qëndrimin dhe trajtimin e të huajve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar..... 7917
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 623, datë 24.9.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugëve “Ali Spahija”, “Nexhip Luli”, “Bujar Bishanaku”, “Stacioni i Trenit”, “Rruga e Kalasë”, si dhe sistemimi i bllokut të pallateve, “Qafë-Hardhi”, të bashkisë së Shkodrës..... 7918
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 624, datë 24.9.2014	Për një ndryshim në vendimin nr. 538, datë 1.5.2008, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e pajisjeve të veçanta, të ngjyrave dhe shenjave për mjetet e Policisë së Shtetit”..... 7920
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 625, datë 24.9.2014	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Shkodër - Hani i Hotit (objekte)..... 7922

Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 18, datë 23.9.2014	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste në Qarkun Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	7923
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 19, datë 23.9.2014	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste në Qarkun Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	7925
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 20, datë 23.9.2014	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste në Qarkun Elbasan, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	7926
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 21, datë 23.9.2014	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste në Qarkun Berat, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë.....	7928

**VENDIM****Nr. 619, datë 24.9.2014**

**PËR EMËRIMIN NË DETYRË TË DY  
ANËTARËVE TË KOMISIONIT  
KOMBËTAR RREGULLATOR TË  
SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË  
DHE TË LARGIMIT E TË PËRPUNIMIT  
TË UJËRAVE TË NDOTURA**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit e të Përpunimit të Ujërave të Ndotura”, të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Emërimin në detyrën e anëtarit të Komisionit Kombëtar Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe të Largimit e të Përpunimit të Ujërave të Ndotura të:

- znj. Silvana Sulstarova;
- z. Riza Ajdini.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 620, datë 24.9.2014**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN  
NR. 411, DATË 20.6.2014, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR  
BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT TË  
STADIUMIT “RUZHDI BIZHUTA”,  
ELBASAN, DHE FINANCIMIN E  
PARKUT OLIMPIK TË TIRANËS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Pika 4, e vendimit nr. 411, datë 20.6.2014, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Efektet financiare për financimin e të dyja projekteve do të mbulohen me 600 000 000 (gjashtëqind milionë) lekë, nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit dhe 44 000 000 (dyzet e katër milionë) lekë, nga fondi i kontingjencës, për vitin 2014”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

**VENDIM****Nr. 621, datë 24.9.2014**

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN  
NR. 418, DATË 27.6.2012, TË KËSHILLIT  
TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN  
E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË  
ANËTARËVE TË KËSHILLAVE,  
BORDEVE OSE KOMISIONEVE TË  
NJËSIVE TË QEVERISJES  
QENDRORE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe shpërblimeve”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Në vendimin nr. 418, datë 27.6.2012, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Lidhja nr. 1, e përmendur në pikën 3, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

b) Në pikën 4, emërtimet “Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta” dhe Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve” zëvendësohen, përkatësisht, me “Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë” dhe “Ministrisë së Kulturës”.

c) Në pikën 5 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) Emërtimi “Ministrisë së Integritimit” zëvendësohet me “Ministrisë së Integritimit Evropian”;

ii) Fjalët “Ministrisë së Punëve Publike dhe Transportit” zëvendësohen me “Ministrisë së



Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit”.

2. Ngarkohen njësitë e qeverisjes qendrore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
Edi Rama

Lista e emërtesës së çdo këshilli, bordi apo komisioni, numri i anëtarëve në përbërje të tyre, numri maksimal i pagesave në një vit pavarësisht numrit të mbledhjeve të kryera, si dhe masa e pagesës të kryetarit dhe anëtarëve për çdo këshill, bord ose komision

Institucioni buxhetor	Emërtesa e Bordit/Këshilli/Komisionit	Numri maksimal i pagesave në një vit	Përbërja		Shpërbllim kryetari (lekë)	Shpërbllim anëtari (lekë)
			Kryetari	Nr. i anëtarëve		
Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes	Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorëve	6	1	4	5,000	5,000
	Komisioni i Ndihmës Shtetërore	6	1	4	10,000	10,000
Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave	Bordi i Autoriteti Kombëtar të Ushqimit	6	1	14	5,000	5,000
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës	Këshilli Rregullimit të Territorit në RSH	6	1	12	20,000	20,000
	Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha	6	1	10	20,000	20,000
	Bordi i Menaxhimit të Autoritetit Rrugor Shqiptar	10	1	6	15,000	12,000
	Këshilli Teknik i Përhershëm i Digave	6	1	4	20,000	20,000
	Komisioni i dhënies së Licencave Profesionale	12	1	6	8,000	7,000
Ministria Financave	Komiteti i Auditit të Brendshëm	4	1	8	15,000	15,000
	Bordi Menaxhimit për Kontrollin e Brendshëm Financiar	4	1	10	20,000	15,000
	Komisioni Kualifikimit për certifikimin e auditëve të Brendshëm në sektorin publik	12	1	4	8,000	7,000
	Këshilli i menaxhimit të Agjencisë së Auditimit të Programeve të Asistencës	9	1	2	10,000	10,000
	Bordi i Qendrës së Trajnimit të Administratës Tatimore dhe Doganore	4	1	3	20,000	15,000
Ministria e Arsimit dhe Sportit	Bordi i Mbikëqyrjes Publike të Ekspertëve Kontabël të Regjistruar	4	1	6	20,000	20,000
	Këshilli i Lartë i Arsimit dhe Shkencës	12	1	18	20,000	15,000
	Këshilli i Akreditimit të Arsimit	9	1	10	20,000	15,000
	Komisioni i Vlerësimit të Titujve Akademike	9	1	14	15,000	13,000
	Këshilli Kombëtar i Sportit	6	1	8	0	5,000
Arsimi i Lartë Publik	Komisioni Antidoping	6	0	9	0	5,000
	Këshilli Administrativ	12	1	ndryshëm	8,000	8,000
	Senati Akademik	9	1	"	8,000	8,000
	Këshilli i fakulteteve	9	1	"	8,000	8,000
	Këshilli i Profesorëve	9	1	"	8,000	8,000
Ministria e Kulturës	Këshilli i Lartë i Arkivave	4	1	17	10,000	5,000
	Këshilli i Lartë i Arkivave	4	1	17	10,000	5,000
	Komisioni Qendror i Ekspertizës	4	1	15	0	5,000
	Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror"	4	1	5	0	5,000
	Komisioni i Përhershëm i Ekspertizave të Vlerësimit të dokumenteve me rëndësi historike kombëtare.	4	1	9	0	5,000
	Këshilli i Lartë i Arkivave	4	1	17	10,000	5,000
	Komisioni Qendror i Ekspertizës	4	1	15	0	5,000
	Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror"	4	1	5	0	5,000
	Komisioni i Përhershëm i Ekspertizave të Vlerësimit të dokumenteve me rëndësi historike kombëtare.	4	1	9	0	5,000
	Këshilli i Lartë i Arkivave	4	1	17	10,000	5,000
	Komisioni Qendror i Ekspertizës	4	1	15	0	5,000
	Komisioni i Deklasifikimit dhe Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar "Sekret shtetëror"	4	1	5	0	5,000
	Komisioni i Përhershëm i Ekspertizave të Vlerësimit të dokumenteve me rëndësi historike kombëtare.	4	1	9	0	5,000
Ministria e Shëndetësisë	Komisioni i vlerësimit të programit mbrojtjes së dëshmitarëve e bashkëpunëtorëve të drejtësisë	12	1	4	20,000	15,000
	Komisioni i posaçëm për dhënie e Licencave të importit, eksportit dhe prodhimit të lëndëve plasëse, fishekzjarrë etj.	9	1	4	5,000	5,000
	Këshilli i Akreditimit të institucioneve shëndetësore	4	1	5	20,000	15,000
	Komisioni i mbrojtjes nga rrezatimi	6	1	7	5,000	5,000
	Komiteti Shtetëror për Planifikimin Spitalor	4	1	10	5,000	5,000
Ministria e Drejtësisë	Komiteti Kombëtar i Transfuzionit të Gjakut	2	1	13	5,000	5,000
	Komisioni i Çmimit të Barnave	12	1	6	5,000	5,000
	Këshilli i Qendrës së Publikimeve Zyrtare	12	1	11	5,000	5,000
	Këshilli drejtues i Komitetit Shqiptar të Birësimeve	12	1	9	5,000	5,000
	Komisioni për licencimin e ndërmjetësve	12	1	4	5,000	5,000
Ministria e Brendshme	Komisioni për Mbrojtjen e Gjyqtarëve	12	1	4	5,000	5,000
	Komisioni Shtetëror për Ndihmën Juridike	10	0	4	0	5,000
	Komisioni i vlerësimit të programit mbrojtjes së dëshmitarëve e bashkëpunëtorëve të drejtësisë	12	1	4	20,000	15,000
	Komisioni i posaçëm për dhënie e Licencave të importit, eksportit dhe prodhimit të lëndëve plasëse, fishekzjarrë etj.	9	1	4	5,000	5,000
	Komisioni i vlerësimit të programit mbrojtjes së dëshmitarëve e bashkëpunëtorëve të drejtësisë	12	1	4	20,000	15,000



Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë	Këshilli Kombëtar i Punës	4	1	27	0	8,000
	Komisioni juridik	3	1	7	5,000	5,000
	Komisioni i Punësimit dhe Formimit Profesional	3	1	7	5,000	5,000
	Komisioni i Shanseve të Barabarta	3	1	7	5,000	5,000
	Komisioni i kushteve të punës, shëndetit dhe sigurisë në punë	3	1	7	5,000	5,000
	Komisioni i pagave dhe pensione	3	1	4	0	5,000
	Komisioni i ekonomisë dhe financave	3	1	7	5,000	5,000
	Zyra shtetërore e pajtimit		1	2	0	Paga ditore e Dr. Drejtorisë * nr. i ditëve për pjesëmarrje në mbledhje
	Zyrat rajonale të pajtimit		12	24	0	Paga ditore Dr. të Zyrës Rajonale * nr. i ditëve për pjesëmarrje në mbledhje
	Këshilli Administrativ i Shërbimit Kombëtar të Punësimit	3	1	12	5,000	5,000
Zyra Administrimit Buxhetit Gjyqësor	Bordi i Zyrës së Administrimit të Buxhetit Gjyqësor	6	1	8	10,000	8,000
Instituti i Statistikave	Këshilli i Statistikave	6	1	10	20,000	12,000
	Komisioni Kombëtar i Nomeklaturës	3	1	18	10,000	8,000
Shkolla e Magjistraturës	Këshilli Drejtues	6	1	15	10,000	10,000
	Këshilli Pedagogjik	2		i ndryshëm	8,000	8,000
Qendra Kombëtare e Kulturës	Këshilla miratues i projekteve të filmit artistik	3		5		20,000
	Këshilla miratues i projekteve të filmit dokumentar	3		5		15,000
	Këshilla miratues i projekteve të filmit vizatimor	3		5		15,000
	Komisioni i Vizionimit	3		2		8,000
	Komisioni Financiar i Filmit Artistik	3		3		15,000
	Komisioni Financiar i Filmit Vizatimor	3		3		8,000
	Komisioni Financiar i Filmit Dokumentar	3		3		8,000
Këshilli i Lartë i Drejtësisë	Këshilli i Lartë i Drejtësisë	12		15	0	10,000
Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit	Bordi Drejtues i Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit	10	1	8	20,000	15,000
Agjencia e Mbrojtjes së Shoqërisë Civile	Bordi Mbikëqyrës i AMSHC	9	1	8	7,000	5,000
Instituti i Studimit të Krimeve kundër Komunizmit	Bordi drejtues	9	1	6	20,000	20,000
	Këshilli Shkencor	6	1	6	15,000	15,000
Akademia e Shkencës	Këshilli i Botimeve	3	1	12	5,000	5,000
	Këshilli Ndërkademi për Gjuhën Shqipe	3	1	12	5,000	5,000
Agjencia Kombëtare e Teknologjisë dhe Inovacionit	Bordi drejtues	6	1	8	20,000	20,000

## VENDIM

Nr. 622, datë 24.9.2014

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 513, DATË 13.6.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE, TË PROCEDURAVE E TË DOKUMENTACIONIT PËR HYRJEN, QËNDRIMIN DHE TRAJTIMIN E TË HUAJVE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, pika 1, shkronja “e”, dhe 22, pika 5, të ligjit nr. 108/2013, “Për të huajt”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

## VENDOSI:

1. Në aneksin 4, “Lista e vendeve, shtetasit e të cilave hyjnë me vizë në Republikën e Shqipërisë dhe përfaqësitë ku mund të bëhet aplikimi, si dhe tarifa përkatëse e shërbimit me vizë”, bashkëlidhur vendimit nr. 513, datë 13.6.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, tarifa e pajisjes me vizë të tipit C me një hyrje, dy hyrje, shumë hyrje dhe për vizë të tipit D, për shtetasit e Kuvajtit, të bëhet 25 euro.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Jashtme dhe Ministria e Punëve të Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI  
**Edi Rama**

**VENDIM**

Nr. 623, datë 24.9.2014

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES  
PUBLIK, TË PRONARËVE TË  
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË  
PRIVATE, QË PREKEN NGA  
RIKONSTRUKSIONI I RRUGËVE “ALI  
SPAHIJA”, “NEXHIP LULI”, “BUJAR  
BISHANAKU”, “STACIONI I TRENIT”,  
“RRUGA E KALASË”, SI DHE  
SISTEMIMI I BLOKUT TË  
PALLATEVE, “QAFË-HARDHI”, TË  
BASHKISË SË SHKODRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga rikonstruksioni i rrugëve “Ali Spahija”, “Nexhip Luli”, “Bujar Bishanaku”, “Stacioni i trenit”, “Rruga e kalasë”, si dhe sistemimi i bllokut të pallateve, “Qafë - Hardhi”, të bashkisë së Shkodrës, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Bashkisë së Shkodrës.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen sipas vlerave të mëposhtme:

a) për rikonstruksionin e “Rruga e kalasë”, sot “Rruga e qafës”, me sipërfaqe 75 (shtatëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup> truall, në vlerën 700 275 (shtatëqind mijë e dyqind e shtatëdhjetë e pesë) lekë;

b) për sistemimin e bllokut të pallateve “Qafë - Hardhi”, me sipërfaqe 177.5 (njëqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë pesë) m<sup>2</sup> truall, në vlerën 1 597 855 (një milion e pesëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind pesëdhjetë e pesë) lekë;

c) për rikonstruksionin e rrugës “Nexhip Luli”, me sipërfaqe 70.5 (shtatëdhjetë pikë pesë) m<sup>2</sup> truall, në vlerën 764 855 (shtatëqind e gjashtëdhjetë e katër mijë e tetëqind e pesëdhjetë e pesë) lekë;

ç) për rikonstruksionin e rrugës “Ali Spahija”, me sipërfaqe 318 (treqind e tetëmbëdhjetë) m<sup>2</sup> truall, në vlerën 3 449 982 (tre milionë e katërqind e dyzet e nëntë mijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy) lekë;

d) për rikonstruksionin e rrugës “Stacioni i trenit”, me sipërfaqe 1 152.65 (njëmijë e njëqind e pesëdhjetë e dy pikë gjashtëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup> truall, në vlerën 9 460 951 (nëntë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë mijë e nëntëqind e pesëdhjetë e një) lekë;

dh) për rikonstruksionin e trotuarit, segment i rrugës “Bujar Bishanaku”, me sipërfaqe 378 (treqind e shtatëdhjetë e tetë) m<sup>2</sup> truall, në vlerën 4 179 162 (katër milionë e njëqind e shtatëdhjetë e nëntë mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 20 153 080 (njëzet milionë e njëqind e pesëdhjetë e tre mijë e tetëdhjetë) lekësh, të përballohet nga të ardhurat e Bashkisë së Shkodrës, planifikuar në buxhetin e saj.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të përballohet nga Bashkia e Shkodrës.

6. Afati i përfundimit të procedurës së shpronësimit të jetë 60 ditë pas datës së hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

7. Afati i përfundimit të punimeve të objektit, në Bashkinë e Shkodrës, të jetë në përputhje me afatet e parashikuara nga kjo Bashki.

8. Regjistrimi i ri i pasurisë për sipërfaqen 2 171.65 (dy mijë e njëqind e shtatëdhjetë e një pikë gjashtëdhjetë e pesë) m<sup>2</sup> truall, të bëhet në favor të Bashkisë së Shkodrës.

9. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme dhe Bashkia e Shkodrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Edi Rama**



**1. LISTA EMRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË RIKONSTRUKSIONIN E RRUGËS SË KALASË, SOT RRUGA E QAFËS, BASHKIA SHKODËR**

Nr	Familja që shpronësohet	Zona Kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip.truallit/m <sup>2</sup>	Çmimi lekë/m <sup>2</sup>	Vlera lekë	Dokum. Pronësie
1	Ardian Isa Tirana	8597	17/90	4	9337	37,348	Vërtetim hipotekor
2	Ardian Isa Tirana	8597	17/93	25	9337	233,425	Vërtetim hipotekor
3	Ardian Isa Tirana	8597	17/92	46	9337	429,502	
	<b>Shuma</b>			<b>75</b>	<b>9337</b>	<b>700 275</b>	

**2. LISTA EMRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË TË SISTEMIMIT TË BLOKUT TË PALLATEVE QAFE - HARDHI (RRUGA ZIJA SHKODRA)**

Nr	Familja që shpronësohet	Zona Kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip.truallit/m <sup>2</sup>	Çmimi lekë/m <sup>2</sup>	Vlera lekë	Dok. Pronësie
1	Qamil Sokoli	8594	7/327	160	9002	1,440,320	Vërtetim hipotekor
	Ilfete Sokoli						
	Ahmet Sokoli						
	Bardhyl Sokoli						
2	Qamil Sokoli	8594	7/308	17.5	9002	157,535	Vërtetim hipotekor
	Ylfete Sokoli						
	Ahmet Sokoli						
	Bardhyl Sokoli						
	<b>Shuma Totale</b>			<b>177.5</b>		<b>1 597 855</b>	

**3. LISTA EMRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË RIKONSTRUKSIONIT TË RRUGËS " NEXHIP LULI "**

Nr	Familja që shpronësohet	Zona Kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip.truallit/m <sup>2</sup>	Çmimi lekë/m <sup>2</sup>	Vlera lekë	Dokum. Pronësie
1	Ilmi Basha	8592	3/462	29	10849	314,621	Ne proces rinovimi
2	Pronar I paidentifikuar	8592		41.5	10849	450,234	Ne proces
	<b>Shuma Totale</b>			<b>70.5</b>		<b>764 855</b>	

**4. LISTA EMRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË RIKONSTRUKSION I RRUGËS 30 KORRIKU, SOT DR. ALI SPAHIJA**

Nr	Familja që shpronësohet	Zona Kadastrale	Nr. i pasurisë	Sip.truallit/m <sup>2</sup>	Çmimi lekë/m <sup>2</sup>	Vlera lekë	Dokum. Pronësie
1	Gacalin Prendushi	8592	9/183	318	10849	3,449,982	Vërtetim hipotekor
2	Antoneta Prendushi						
3	Justina Prendushi						
4	Gjyzeqina Prendushi						
5	Luigjina Prendushi						
6	Nikolin Prendushi						
	<b>Shuma Totale</b>			<b>318</b>		<b>3 449 982</b>	

**5. LISTA EMRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË "RIKONSTRUKSIONIT TË RRUGËS STACIONI I TRENIT"**

Nr	Familja që shpronësohet	Zona Kadastrale	Sip.truallit/m <sup>2</sup>	Çmimi lekë/m <sup>2</sup>	Vlera lekë	Dokument hipotekor
1	Agustin Gajolla	8593	90	8208	738720	Proces
2	Vincens Gjonaj	8593	105.6	8208	866764.8	Proces
3	Julanda Brahimaj, Donald Gj. Brahimaj	8593	43.7	8208	358689.6	Vërtetim hipotekor
4	Pal Marku	8593	57.7	8208	473601.6	Proces
5	Martin Shllaku	8593	25	8208	205200	Proces
6	Nikolin Shllaku	8593	11	8208	90288	Proces
7	Gjovalin Karroca	8593	40	8208	328320	Proces
8	Pellumb Gega	8593	21	8208	172368	Vërtetim hipotekor
9	Leonard Kepi	8593	100	8208	820800	Proces
10	Çesk Rrok Shllaku	8593	48.5	8208	398088	Vërtetim hipotekor
11	Lodovik Karroca	8593	31.5	8208	258552	Vërtetim hipotekor
12	Lodovik Karroca	8593	5.25	8208	43092	Vërtetim hipotekor
13	Lodovik Karroca	8593	62	8208	508896	Vërtetim hipotekor
14	Lek Marku ( Zef Krrabi )	8593	18	8208	147744	Proces
15	Tonin Sukori	8593	24	8208	196992	Proces
16	Trashigimtaret Gjinaj	8593	46	8208	377568	Proces
17	Gjin Blinishta	8593	148	8208	1214784	Proces
18	Lucian Leci	8593	24.4	8208	200275.2	Proces
19	Mark Gjeka	8593	220	8208	1805760	Vërtetim hipotekor
20	Ndue Pjetra	8593	31	8208	254448	Proces
	<b>Shuma Totale</b>		<b>1152.65</b>		<b>9 460 951</b>	



**6. LISTA EMRORE E PERSONAVE DHE PRONAVE QË DO TË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË**

**"RIKONSTRUKSIONIT TË TROTUARIT SEG. RRUGA "BUJAR BISHANAKU"**

Nr	Familja që shpronësohet	Zona kadastrale	S.Trualli/m <sup>2</sup>	Cmimi/lekë/m <sup>2</sup>	Vlera/lekë	Sip/objekti	Vlera/lekë	Vlera e Amortizimit	Totali	Dokum. Pronësie
1	Hysen Kiri	8592	184.5	10849	2001640.5				2001640.5	
2	Nexhmedin Shyqyri Banja	8592	52.5	10849	569572.5	mur	88,108	9868	647812.5	Vertetim hipotekor
3	Sejhan Zyhdi Banja	8592	58.5	10849	634666.5				634666.5	Vertetim hipotekor
4	Skender Mesi	8592	48	10849	520752				520752	Vertetim hipotekor
5	Arben Rexhep Rexhvelaj	8592	34.5	10849	374290.5				374290.5	Vertetim hipotekor
	<b>Shuma Totale</b>		<b>378</b>		<b>4100922</b>				<b>4 179 162</b>	

**VENDIM**

**Nr. 624, datë 24.9.2014**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 538, DATË 1.5.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRCAKTIMIN E PAJISJEVE TË VEÇANTA, TË NGJYRAVE DHE SHENJAVE PËR MJETET E POLICISË SË SHPETIT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe pikës 2, të nenit 5, të ligjit nr. 9749, datë 4.6.2007, "Për Policinë e Shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**


Fjalja e fundit e pikës 2, të vendimit nr. 538, datë 1.5.2008, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

"...Ngjyra, targa dhe logoja në mjetet e uniformuara të Policisë së Shtetit janë të njëjta, me përjashtim të mjeteve të sektorit të forcës së posaçme "Shqiponja" dhe Sigurisë së Shoqërimin, të cilat do të kenë ngjyrë dhe dizeno sipas lidhjes nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi, e cila është pjesë përbërëse e tij".


Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Edi Rama**

Lidhja nr.1








Rrethi vogel diam 9.5 cm

Rrethi I madh dim.16 cm

Logo e vogel "Skuadra shqiponja" mbrapa



Logo e madhe "Skuadra shqiponja" 4-cope

Rrethi vogel diam 19 cm

Rrethi I madh dim.30 cm

Mbishkrimi POLICIA Mbrapa trashesia e shkronjave 4,5cm

79 cm

14cm



84 cm

Mbishkrimi POLICIA anesor trashesia e shkronjave 7 cm

111 cm

20cm



119 cm



Shiriti bardhe poshte xhamave	5.5 cm
Shiriti portokalli	7 cm
Shiriti blu	4 cm
Bardhe	10.5cm
20cm	
<b>P O L I C I A</b>	
Shiriti blu	2 cm
Shiriti portokalli	10,5 cm

**VENDIM**

Nr. 625, datë 24.9.2014

**PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES  
PUBLIK, TË PRONARËVE TË  
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË  
PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI  
I SEGMENTIT RRUGOR SHKODËR -  
HANI I HOTIT (OBJEKTE)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, dhe të ligjit nr. 185/2013, “Për buxhetin e vitit 2014”, me propozimin e ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Shkodër - Hani i Hotit (objekte).

2. Shpronësimi bëhet në favor të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për objekte, me vlerë të përgjithshme 9 162 713 (nëntë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e trembëdhjetë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit prej 9 162 713 (nëntë milionë e njëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e shtatëqind e trembëdhjetë) lekësh të përballohet nga buxheti i vitit 2014, zëri “Detyrimet e prapambetura, (detyrimet e infrastrukturës)”.

5. Shpenzimet procedurale, në vlerën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, të përballohen nga Autoriteti Rrugor Shqiptar.

6. Likuidimi i pronarëve të fillojë pas çeljes së fondit të përcaktuar në pikën 4, të këtij vendimi.

7. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi “Konfirmuar nga ZVRPP-ja”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, në bazë të dokumentacionit të plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

8. Pronarët e pasurive, për të cilat është bërë shënimi “Proces regjistrimi, kufizuar”, të likuidohen, për efekt shpronësimi, pasi të kenë plotësuar dokumentacionin e plotë të pronësisë që do të dorëzojnë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

9. Autoriteti Rrugor Shqiptar të kryejë likuidimet për efekt shpronësimi në bazë të pikave 4, 5, 6 dhe 7, të këtij vendimi.

10. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga



Autoriteti Rrugor Shqiptar, dhe me fillimin e procesit të likuidimit të fillojë dhe procesi i kalimit të pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

11. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në çastin kur do të realizohen procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

**AUTORITETIT RRUGOR SHQIPTAR  
DREJTORISË PROJEKTEVE TË HUAJA  
TË BRENDSHME DHE SHPRONËSIMIT**

Lista emërore e pronarëve që shpronësohen për objektet që preken nga ndërtimi i rrugës  
“Shkodër-Hani Hotit”

Nr.	Pronari			Numri rendor sipas listave të publikimit	Z.K.	Nr. Pas.	Emërtimi i objektit	Vlefë (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri						
1	Xhabir	Zyber	Mehmeti	52 lista nr.2	3429	101/4	Karburant	684484	Proces regjistrimi
2	Ilir	Ali	Rama (Muja)	20 lista nr.1	1495	153/26	Dyqan	2556047	Konfirmuar nga ZVRPP
3	Avni	Rrustem	Aliaj	3 lista nr.1	1495	28/27	Dyqan	3520532	Kufizuar
4	Niko	Mark	Nika	30 lista nr.1	1495	28/30	Dyqan	2401650	Konfirmuar nga ZVRPP
	<b>Shuma</b>							<b>9162713</b>	

**VENDIM  
Nr. 18, datë 23.9.2014**

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË  
DEPUTETIT TË KUVENDIT  
KANDIDATIT TË LISTËS  
SHUMEMËRORE TË PARTISË  
SOCIALISTE NË QARKUN TIRANË,  
PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË  
NJOFTUAR NGA KUVENDI I  
SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 23.9.2013, me pjesëmarrjen e:

Lefterije	Luza	kryetare
Hysen	Osmanaj	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste, në Qarkun Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Ditmir Bushati.

12. Ngarkohen Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTRI  
Edi Rama**

**KËRKUES:** Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 175, pika 2 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

**VËREN**

Nëpërmjet shkresës nr. 3080/1 prot., datë 19.9.2014, drejtuar KQZ-së, sekretarja e përgjithshme e Kuvendit znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të Z. Ditmir Bushati, deputet i zonës zgjedhore qarku Tiranë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.



Kolegji Zgjedhor me vendimin nr. 36, datë 2.8.2013 ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore qarku Tiranë, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Socialiste për zonën zgjedhore qarku Tiranë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013 ka fituar 16 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste për qarkun e Tiranës, janë si më poshtë: me numër rendor 1 (një) Pandeli Majko, me numër rendor 2 (dy) Saimir Tahiri, me numër rendor 3 (tre) Vasilika Hysi, me numër rendor 4 (katër) Ditmir Bushati, me numër rendor 5 (pesë) Fatmir Xhafaj, me numër rendor 6 (gjashtë) Lindita Nikolla, me numër rendor 7 (shtatë) Besnik Baraj, me numër rendor 8 (tetë) Xhemal Qefalia, me numër rendor 9 (nëntë) Sadri Abazi, me numër rendor 10 (dhjetë) Parid Cara, me numër rendor 11 (njëmbëdhjetë) Spartak Braho, me numër rendor 12 (dymbëdhjetë) Artan Gaçi, me numër rendor 13 (trembëdhjetë) Pjerin Ndreu, me numër rendor 14 (katërmëdhjetë) Rakip Suli, me numër rendor 15 (pesëmbëdhjetë) Milena Harito, me numër rendor 16 (gjashtëmbëdhjetë) Dashamir Peza. Pas dorëheqjes nga mandati i deputetes të znj. Milena Harito, KQZ-ja, me vendimin nr. 843, datë 18.12.2013 “Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të radhës të listës shumemërore të Partisë Socialiste në qarkun Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë” vendosi t’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste qarku Tiranë, znj. Enkelejda Hamit Shkreli. Zj. Enkelejda Shkreli është me nr. rendor 17 në listën shumemërore të PS-së në zonën zgjedhore qarku Tiranë. Pas dorëheqjes nga mandati i deputetes të zj. Lindita Nikolla, KQZ-ja vendosi t’i jap mandatin e deputetit zj. Blerina Gjylameti. Zj. Blerina Gjylameti është renditur e 22 (njëzetë e dy) në listën shumemërore të PS-së në qarkun Tiranë.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste në qarkun Tiranë nuk plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, dhe konkretisht nuk plotëson kriterin e gjinisë duke mos pasur 30% nga secila gjini në listën shumemërore. KQZ-ja, me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013 vendosi sanksionin

administrativ gjobë në masën 6 milionë lekë ndaj partisë socialiste. Në bazë të nenit 175, pika 2 të Kodit Zgjedhor KQZ-ja në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e PS-së në zonën zgjedhore qarku Tiranë duhet të zbatojë dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatit e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar deri në plotësimin e kuotës gjinore.

Sipas dispozitave të sipërcituara në çdo rast rezulton se vakanca e krijuar nga heqja dorë nga mandati i deputetit z. Ditmir Bushati, do të zëvendësohet, nga kandidatja e parë e gjinisë më pak të përfaqësuar e cila renditet pas znj. Blerina Gjylameti në listën shumemërore të Partisë Socialiste në qarkun Tiranë.

KQZ me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013 “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste, pjesëtare e koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste për 12 zonat zgjedhore, së bashku me deklaratat model 03, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas deklaratës model 03 “Deklarim për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore” të depozituar nga PS-ja në dokumentacionin e listës shumemërore të zonës zgjedhore qarku Tiranë rezulton se kandidatja e radhës sipas deklaramit është kandidatja me nr. rendor 27 (njëzet e shtatë) znj. Erjeta Lulzim Alhysa.

Për sa më sipër mandat i ndërprerë i përket kandidatës me numër rendor 27 (njëzetë e shtatë) znj. Arjeta Alhysa, të listës së Partisë Socialiste në zonën zgjedhore qarku Tiranë.

#### PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe neni 175, pika 2 të ligjit nr.10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

#### VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste qarku Tiranë, znj. Erjeta Lulzim Alhysa.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

### VENDIM

Nr. 19, datë 23.9.2014

## **PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE NË QARKUN TIRANË, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 23.9.2014, me pjesëmarrjen e:

Lefterije	Luzi	kryetare
Hysen	Osmanaj	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

**OBJEKT:** Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste, në qarkun Tiranë, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Saimir Tahiri.

**KËRKUES:** Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 175, pika 2, neni 164 pika 2 e ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoji diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

### VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 3081/1 prot., datë 19.9.2014, drejtuar KQZ-së, sekretarja e përgjithshme e Kuvendit znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Saimir Tahiri, deputet i zonës zgjedhore qarku Tiranë.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja, merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor me vendimin nr. 36, datë 2.8.2013 ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore qarku Tiranë, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Socialiste për zonën zgjedhore qarku Tiranë për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013 ka fituar 16 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste për qarkun e Tiranës, janë si më poshtë: me numër rendor 1 (një) Pandeli Majko, me numër rendor 2 (dy) Saimir Tahiri, me numër rendor 3 (tre) Vasilika Hysi, me numër rendor 4 (katër) Ditmir Bushati, me numër rendor 5 (pesë) Fatmir Xhafaj, me numër rendor 6 (gjashtë) Lindita Nikolla, me numër rendor 7 (shtatë) Besnik Baraj, me numër rendor 8 (tetë) Xhemal Qefalia, me numër rendor 9 (nëntë) Sadri Abazi, me numër rendor 10 (dhjetë) Parid Cara, me numër rendor 11 (njëmbëdhjetë) Spartak Braho, me numër rendor 12 (dymbëdhjetë) Artan Gaçi, me numër rendor 13 (trembëdhjetë) Pjerin Ndreu, me numër rendor 14 (katërmëdhjetë) Rakip Suli, me numër rendor 15 (pesëmbëdhjetë) Milena Harito, me numër rendor 16 (gjashtëmbëdhjetë) Dashamir Peza.

Pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetes të Kuvendit të Shqipërisë të znj. Milena Harito, deputete e zonës zgjedhore Qarku Tiranë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 843, datë 18.12.2013 i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë znj. Enkelejda Shkreli.

Pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetes të Kuvendit të Shqipërisë të znj. Lindita Nikolla, deputete e zonës zgjedhore qarku Tiranë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 851, datë 26.12.2013 i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë znj. Blerina Gjylamati.



Pas njoftimit nga Kuvendi për krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të z. Ditmir Bushati, deputet i zonës zgjedhore qarku Tiranë, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimin nr. 18, datë 23.9.2014 i ka dhënë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë znj. Erjeta Alhysa.

Rezulton se lista shumëmemërore e Partisë Socialiste në qarkun e Tiranës nuk i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, dhe konkretisht nuk plotëson kriterin e gjinisë, duke mos pasur një në tre emrat e parë kandidat nga secila gjini. KQZ-ja, me vendimin nr. 341, datë 11.05.2013 vendosi sanksionin administrativ gjobë në masën 6 milion lekë ndaj Partisë Socialiste. Në bazë të nenit 175, pika 2 të Kodit Zgjedhor, KQZ-ja në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumëmemërore e PS-së, në zonën Zgjedhore qarku Tiranë duhet të zbatonte dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatin e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar.

KQZ-ja, me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013 “Për miratimin e listave shumëmemërore të Partisë Socialiste, pjesëtare e Koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumëmemërore të Partisë Socialiste për 12 zonat zgjedhore, së bashku me deklaratat model 03, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumëmemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas deklaratës model 03, rezulton se gjinia femërore, si gjinia më pak e përfaqësuar në listën shumëmemërore qarku Tiranë, ka shteruar. Në mbështetje të nenit 164 pika 2 (fjalë e fundit) duke qenë se lista e gjinisë femërore ka shteruar, KQZ-ja nuk mund të zbatojë sanksionin plotësues.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë duhet t'i kalojë kandidatit vijues të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste, të zonës zgjedhore qarku Tiranë.

Sipas listës shumëmemërore të Partisë Socialiste për qarkun Tiranë kandidati vijues është kandidati i cili renditet me numër rendor 18 (tetëmbëdhjetë) z. Ervin Bushati. Nga verifikimi i dokumentacionit të mësipërm rezulton se personit, të cilit do t'i kalojë mandati si deputet

për në Kuvendin e Shqipërisë nga lista shumëmemërore për të plotësuar vendin vakant të krijuar nga dorëheqja e z. Saimir Tahiri dhe shterimit të kandidatëve të gjinisë femërore është z. Ervin Alfred Bushati.

#### PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a”, neni 164 pika 2 dhe nenin 175, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar,

#### VENDOSI:

T'i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste qarku Tiranë, z. Ervin Alfred Bushati.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

#### VENDIM

Nr. 20, datë 23.9.2014

### **PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE NË QARKUN ELBASAN, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 23.9.2014, me pjesëmarrjen e:

Lefterije	Luzi	kryetare
Hysen	Osmanaj	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare

Shqyrtoi çështjen me:

OBJEKT: Për dhënie e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumëmemërore të Partisë Socialiste, në Qarkun Elbasan, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të z. Damian Gjikhuri.



**KËRKUES:** Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa a, neni 164, pika 2 i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

#### VËREN:

Nëpërmjet shkresës nr. 3082/1 prot., datë 19.9.2014, drejtuar KQZ-së, Sekretarja e Përgjithshme e Kuvendit znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të Z. Damian Gjikhuri, deputet i zonës zgjedhore qarku Elbasan.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit, Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor, me vendimin nr. 30, datë 2.8.2013 ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore qarku Elbasan, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Socialiste për zonën zgjedhore Qarku Elbasan për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013 ka fituar 6 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste për qarkun Elbasan, janë si më poshtë: me numër rendor 1 (një) Ben Blushi, numër rendor 2 (dy) Damian Gjikhuri, numër rendor 3 (tre) Evis Kushi, numër rendor 4 (katër) Alfred Peza, numër rendor 5 (pesë) Taulant Balla, numër rendor 6 (gjashtë) Musa Ulqini.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste në qarkun Elbasan nuk plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, dhe konkretisht nuk plotëson kriterin e gjinisë duke mos pasur 30% nga secila gjini në listën shumemërore. KQZ-ja, me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013 vendosi sanksionin administrativ gjorbë në masën 6 milion lekë ndaj Partisë Socialiste. Në bazë të nenit 175, pika 2 të

Kodit Zgjedhor KQZ në rast vakance të krijuar në mandatet e fituara nga lista shumemërore e PS-së në zonën zgjedhore qarku Elbasan duhet të zbatojë dhe sanksionin plotësues, duke zëvendësuar vakancën e krijuar me kandidatit e radhës nga gjinia më pak e përfaqësuar deri në plotësimin e kuotës gjinore.

Sipas dispozitave të sipërcituara në çdo rast rezulton se vakanca e krijuar nga heqja dorë nga mandati i deputetit i z. Damian Gjikhuri, do të zëvendësohet, nga kandidatja e parë e gjinisë më pak të përfaqësuar e cila renditet pas znj. Evis Kushi në listën shumemërore të Partisë Socialiste në Qarkun Elbasan.

KQZ-ja, me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013 “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste, pjesëtare e Koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste për 12 zonat zgjedhore, së bashku me deklaratat model 03, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas deklaratës model 03 “Deklarim për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore” të depozituar nga PS-ja në dokumentacionin e listës shumemërore të zonës zgjedhore qarku Elbasan rezulton se kandidatja e radhës sipas deklaramit është kandidatja me numër rendor 9 (nëntë) znj. Luljeta Abedin Arapi.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i përket kandidatës me numër rendor 9 (nëntë) znj. Luljeta Abedin Arapi, të listës së Partisë Socialiste në Zonën Zgjedhore Qarku Elbasan.

#### PËR KËTO ARSYE,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

#### VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste qarku Elbasan, znj. Luljeta Abedin Arapi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.



Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

### VENDIM

Nr. 21, datë 23.9.2014

## PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË PARTISË SOCIALISTE NË QARKUN BERAT, PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS SË NJOFTUAR NGA KUVENDI I SHQIPËRISË

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në mbledhjen e datës 23.09.2014, me pjesëmarrjen e:

Lefterije	Luza	kryetare
Hysen	Osmanaj	anëtar
Klement	Zguri	anëtar
Vera	Shtjefni	anëtare

Shqyrtoi çështjen me

**OBJEKT:** Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit kandidatit të listës shumemërore të Partisë Socialiste, në qarkun Berat, për plotësimin e vakancës së njoftuar nga Kuvendi i Shqipërisë pas heqjes dorë nga mandati i deputetit të znj. Ermonela Valikaj (Felaj).

**KËRKUES:** Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

**BAZA LIGJORE:** Neni 23, pika 1, germa “a”, neni 164, pika 2, i ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

KQZ-ja, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur dhe dëgjoi diskutimet e përfaqësuesve të partive politike,

### VËREN

Nëpërmjet shkresës nr. 3083/1 prot., datë 19.9.2014, drejtuar KQZ-së, sekretarja e përgjithshme e Kuvendit znj. Albana Shtylla, njofton krijimin e vakancës për shkak të heqjes dorë nga mandati i deputetit të Kuvendit të Shqipërisë të znj. Ermonela Valikaj (Felaj), deputete e zonës zgjedhore qarku Berat.

Neni 164 i Kodit Zgjedhor përcakton se në rast të ndërprerjes së mandatit të deputetit,

Kuvendi njofton KQZ-në për krijimin e vakancës dhe KQZ-ja merr vendim për dhënien e mandatit kandidatit të radhës në listën shumemërore të së njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse, regjistruar sipas nenit 67 të Kodit Zgjedhor.

Kolegji Zgjedhor me vendimin nr. 31, datë 2.8.2013 ka shpërndarë mandatet dhe ka përcaktuar kandidatët fitues për zonën zgjedhore qarku Berat, në zgjedhjet për Kuvendin të vitit 2013. Sipas vendimit të sipërcituar Partia Socialiste për zonën zgjedhore qarku Berat për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të datës 23 Qershor 2013 ka fituar 4 mandate dhe kandidatët fitues nga lista shumemërore e Partisë Socialiste për qarkun e Berat, janë si më poshtë: me numër rendor 1 (një) Fidel Ylli, me numër rendor 2 (dy) Ermonela Valikaj (Felaj), me numër rendor 3 (tre) Eduart Shalsi, me numër rendor 4 (katër) Eduart Bejko.

Rezulton se lista shumemërore e Partisë Socialiste në qarkun Berat i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë. Në këto kushte zëvendësimi i vakancës do të bëhet sipas përcaktimeve të nenit 164, pika 2. Gjithashtu, konstatojmë se vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67 të Kodit Zgjedhor. Përpara krijimit të vakancës mandati i përkiste kandidates Znj. Ermonela Valikaj (Felaj) e cila i përket gjinisë më pak të përfaqësuar, në këto kushte në plotësimin e vakancës, KQZ-ja do të zbatojë përjashtimin e përcaktuar në nenin 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor.

KQZ me vendimin nr. 337, datë 11.5.2013 “Për miratimin e listave shumemërore të Partisë Socialiste, pjesëtare e Koalicionit “Aleanca për Shqipërinë Europiane” për zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë 2013”, ka miratuar listën shumemërore të Partisë Socialiste për 12 zonat zgjedhore, së bashku me deklaratat model 03, për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore për çdo zonë zgjedhore.

Sipas nenit 164, pika 2 të Kodit Zgjedhor, vakanca do të plotësohet nga kandidatja e parë në listë pas zonjës Ermonela Valikaj (Felaj) që i përket gjinisë femërore. Sipas deklaratës model 03 “Deklarim për vendet sipas kuotës gjinore të listës shumemërore” të depozituar nga PS-ja në





dokumentacionin e listës shumemërore të zonës zgjedhore qarku Berat, rezulton se kandidatja e radhës sipas deklaramit është kandidatja me numër rendor 8 (tetë) znj. Anila Estref Agalliu.

Për sa më sipër, mandat i ndërprerë i përket kandidates me numër rendor 8 (tetë) znj. Anila Estref Agalliu të listës së Partisë Socialiste në zonën zgjedhore Qarku Berat.

#### PËR KËTO ARSYE:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, mbështetur në nenin 23, pika 1, germa “a” dhe nenin 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar,

#### VENDOSI:

T’i japë mandatin e deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të Partisë Socialiste Qarku Berat, znj. Anila Estref Agalliu.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor, pranë Gjykatës së Apelit Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga shpallja e këtij vendimi.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare me çmimin 16 000 lekë ose pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare me çmimin 14 000 lekë (ky çmim nuk përfshin shpërndarjen në adresë).

	Formati 61x86/8
--	-----------------

**Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare  
Tiranë, 2014**

**Adresa**

Bulevardi “Gjergj Fishta”,  
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,  
Tel:042427005, 04 2427006

**Çmimi 20 lekë**